

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lavrov kërcënon Europën: Nëse na sulmoni, lufta do të jetë shumë e shkurtër... Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/lavrov-kercenon-europen-nese-na-sulmoni-lufta-do-te-jete-shume-e-shkurter/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:52:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:43:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3b24dddc3fa708014fba44a61d3c44f053452b819cac8b45494e9374265fbfc6
TEKSTI	9f9d20913fb9d4ebba9d8bf67bf106144e988097de85983bd9d80b3d720f3fb9
PAMJA	6f25d379254af90f3484866d6718c890952783278bb93af3b788f7efabde3fb0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	67bd8acd0a81fe3b7e1b9acb3edf9ca8a2d557bf49c1171506e2cca6b313c41d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/67bd8acd0a81fe3b7e1b9acb3edf9ca8a2d557bf49c1171506e2cca6b313c41d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Lavrov kërcënon Europën: Nëse na sulmoni, lufta do të jetë shumë e shkurtër...

Eriselda Doko

28 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Tensionet mes Rusisë dhe Europës po marrin tone gjithnjë e më të ashpra. Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka paralajmëruar se një përplasje e drejtpërdrejtë ushtarake mes Moskës dhe vendeve europiane do të ishte një luftë “krejtësisht ndryshe” dhe “shumë e shkurtër”, një deklaratë që ka ngritur shqetësime për shkallën që mund të merrte një konflikt i tillë. Lavrov ka këmbëngulur se Rusia nuk synon të sulmojë Europën, por paralajmërimi i tij ishte i drejtpërdrejtë në rast se, sipas tij, Moska sulmohet e para.

“Rusia ka thënë vazhdimisht se ne nuk do të sulmojmë vendet perëndimore dhe nuk kemi interes ta bëjmë këtë. Por nëse Europa, e cila flet rregullisht për përgatitjen për luftë kundër Rusisë, sulmon Federatën Ruse, atëherë kjo do të jetë një luftë krejtësisht tjetër dhe do të jetë shumë e shkurtër”, deklaroi Lavrov.

Kryediplomati rus akuzoi udhëheqësit europianë se po ushqejnë vetë një klimë konfrontimi me Moskën, përmes rritjes së shpenzimeve ushtarake dhe paralajmërimeve se kontinenti duhet të përgatitet për një konflikt të mundshëm me Rusinë.

Sipas Lavrovit, kjo retorikë rrezikon të kthehet në një “profeci vetëpërbushëse”. Ai pretendoi se investimet masive në industrinë e mbrojtjes mund të krijojnë një situatë ku, në një moment të caktuar, politikanë europianë mund të shtyhen drejt përdorimit të arsenalit të grumbulluar.

Deklaratat vijnë në një moment veçanërisht të tensionuar në marrëdhëniet me Moskës dhe Berlinin. Në Nju Jork, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Lavrov zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm gjerman Johann Wadephul, i pari takim dypalësh mes ministrave të Jashtëm të dy vendeve që prej nisjes së pushtimit të plotë rus të Ukrainës në vitin 2022. Biseda zgjati rreth 20 minuta.

Wadephul i kërkoi Moskës të heqë dorë nga ajo që Berlini e cilëson si “rrugë e rrezikshme e përshkallëzimit” ndaj Gjermanisë, Europës dhe NATO-s. Ai argumentoi gjithashtu se europianët nuk duhet t’ua lënë vetëm Shteteve të Bashkuara komunikimin me Rusinë dhe se kanalet e

drejtpërdrejta të dialogut duhet të mbeten të hapura.

Por takimi nuk e uli temperaturën e përplasjes. Lavrov drejtoi akuza të forta ndaj Gjermanisë dhe kancelarit Friedrich Merz, duke iu referuar deklaratave të tij për forcimin e kapaciteteve ushtarake gjermane.

“Kancelari Merz po deklaroi se Gjermania duhet të bëhet sërish një fuqi kryesore ushtarake në Europë. A e kupton Berlini se ku mund të çojë kjo? A nuk i kanë mësuar mësime të Luftës së Dytë Botërore?”, deklaroi Lavrov gjatë qëndrimit të tij në OKB.

Kryediplomati rus ka përdorur gjithashtu referenca historike ndaj Gjermanisë naziste për të sulmuar politikën e sotme të Berlinit, ndërsa Moska vazhdon ta paraqesë rritjen e kapaciteteve ushtarake europiane si një kërcënim të drejtpërdrejtë ndaj sigurisë së saj.

Nga ana tjetër, Berlini e sheh situatën në drejtim të kundërt. Wadeputh tha pas takimit se Rusia duhet ta kuptojë se Gjermania është e gatshme “të rezistojë dhe të mbrohet”, ndërsa kërkoi që Moska të ndalë përshkallëzimin dhe të tregojë vullnet real për përfundimin e luftës në Ukrainë.

LAJME TË NGJASHME



Ku jetohej më mirë në Europë?

2.5 MIN



'Jemi më të fortë se Rusia', Rutte: Moska nuk do ta përçajë NATO-n, do të shtojmë mbështetjen për Ukrainën

2.5 MIN




UEFA korrigjon gabimin, zyrtarizohet rruga për Egnatian në Europë

1 MIN



Të dërguarit e SHBA-së bisedime në Moskë dhe Kiev, Trump për të deleguarit: "Dy negociatorë të shkëlqyer"!

1 MIN



Të dërguarit e Trump mbërrijnë në Moskë, Vladimir Putin urdhëron armëpushim tre-ditor me Kievin!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Andy Carroll rikthehet në fushën e futbollit pas rrëfimit për sulmin seksual!




Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përgjeshur nga Deejay-t e TAR!



"Patëm një dasmë të madhe shqiptare..." / Dua Lipa ndan pamje nga dasma familjare!



Ben Affleck pranon se fëmijët qeshin me të kur përpigjet t'u japë këshilla për dashurinë?



Rita Ora tërheq vëmendjen me paraqitjen e fundit, vë në pah linjat trupore!



Vdekja e Giorgos Mazonakis, zbulohet mesazhi i fundit për trajtimin dhe pagesën...



"Para nga qielli"/Parashikimi i Baba Vanga-s për dy shenjat e zodiakut!



Nga dhoma e hotelit me Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe!



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!

EDITORI SUGJERON



Vjeshta kalohet më bukur me muzikën e përzgjedhur nga DeeJay-t e TAR!



Këshilli i Sigurisë Kombëtare mbledhet urgjentisht pas rastit të Vlora Hysenit, Muhamed Veliu jep detajet: Kush do të jetë në krye të SHISH?



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!



Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...



Keni rënë në dashuri?! Apo është thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërtoni telefonin sipas Mateo Kadriut...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zotëdhur shqiptare dhe të huat me edicionet

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Koniimi nëndorimi an

LINKS

Kontaktoni Marketing

informative dhe një larmi programesh kulturore.
27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje
penale.

Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.